



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 1 korrik, Trupi Gjykses në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit miratoi pjesërisht një kërkesë të përbashkët të Mbrojtjes për ndryshimin e afateve për paraqitjen e provave nga të katër ekipet e Mbrojtjes në këtë gjykim.

Në varësi të rezultatit mocionit të Mbrojtjes për rrëzimin e akuzave, ekipet e Mbrojtjes duhet të njoftojnë Trupin Gjykses deri më 16 korrik 2025 nëse synojnë të paraqesin prova, si dhe të dorëzojnë listën e dëshmitarëve dhe të provave materiale, jo më vonë se më 21 korrik. Konferenca për ecurinë e çështjes është caktuar për të martën, 22 korrik, në orën 14:00, për të siguruar se po ndërmerren me zell të gjithë hapat për kryerjen e përgatitjeve të nevojshme për përfundimin e çështjes gjyqësore.

Në vendim, Trupi Gjykses miratoi kërkesën e Mbrojtjes që konferenca përgatitore për Mbrojtjen të mbahet pas pushimit veror të Gjykatës, dhe e caktoi seancën për të martën, 19 gusht 2025, në orën 10:00 paradite. Trupi Gjykses u kërkoi palëve dhe pjesëmarrësve të përgatiten për fillimin e paraqitjes së provave nga Mbrojtja në javën vijuese, me paraqitjen e provave nga i pandehuri i parë në Aktakuzë, në qoftë se do të paraqesë prova dhe, në qoftë se jo, me paraqitjen e provave nga i pandehuri i radhës që vendos të paraqesë prova.

Po atë ditë, Trupi Gjykses në këtë çështje gjyqësore miratoi pjesërisht tri kërkesa të ekipeve të Mbrojtjes për apelim të disa vendimeve të mëparshme me të cilët Trupi Gjykses kishte pranuar si prova disa raporte si "materiale burimore" dhe jo si "aktekspertiza". Trupi Gjykses u bind se aspekti nëse dokumentet që shprehin njëfarë ekspertize duhet të konsiderohen dhe trajtohen si aktekspertiza është aspekt i apelueshëm, sepse zgjidhja e tij mund të ketë ndikim në drejtësinë e procesit dhe mund të ndikojë gjithashtu në mënyrën se si duhet t'i trajtojë Gjykses ato prova kur të bëjë vlerësimin e peshës dhe vlerës provuese të tyre.

Trupi Gjykses gjykoi gjithashtu se është në dobi të zhvillimit të procesit dhe në përputhje me të drejtat e të akuzuarve që çdo mospajtim lidhur me zbatimin dhe interpretimin e rregullës mbi pranimin e aktekspertizave të shqyrtohet nga Paneli i Gjykatës së Apelit dhe se zgjidhja e këtij aspekti mund të ketë ndikim mbi kuadrin e argumenteve të Prokurorisë, mundësinë e palëve dhe të pjesëmarrësve për të bërë parashtrime të bazuara në informacion në lidhje me ato prova, si dhe mbi paraqitjen e provave nga Mbrojtja, nëse do të ketë.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit lidhur me pretendime për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, këtë javë u bë publik një vendim i lëshuar më 7 maj. Në vendim, Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi Administratoren të caktonte një mbrojtës të pavarur për të shqyrtuar materiale të sekuestruara në kuadër të masave hetimore të posaçme, me qëllim





evidentimin e informacionit konfidencial para se Prokuroria të autorizohet të ketë qasje në ato materiale, duke pasur parasysh se z. Kuçi ishte pjesë e ekipit të Mbrojtjes së Veselit.

Pas dorëzimit të raportit përfundimtar nga mbrojtësi i pavarur, Gjykatësja e Procedurës Paraprake do të lëshojë urdhra të mëtejshëm, nëse është e përshtatshme, si dhe do të japë udhëzime të mëtejshme për trajtimin e materialit të privilegjuar të evidentuar nga mbrojtësi i pavarur.

Më 1 korrik, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, hodhi poshtë mocionet paraprake të të akuzuarve për shtyrje të fillimit të procesit dhe veçimin e çështjeve gjyqësore.

Mbrojtja e z. Thaçi kishte kërkuar që gjykimi i z. Thaçi të ndahet nga ai i të bashkakuzuarve të tij dhe që gjykimi i tij të shtyhet deri pas përfundimit të procesit për krime lufte. Ai argumentoi se ndryshe do t'i duhej të përballej me pjesët më kritike të dy gjykimeve njëkohësisht, që do t'ia bënte shumë të vështirë të merrte pjesë në mënyrë efektive në proces. Sipas tij, kjo do të shkelte edhe të drejtën e tij për përfaqësim juridik të efektshëm, sepse nuk ka mjetet financiare për të paguar dy ekupe mbrojtjeje. Krahas kësaj, ai parashtroi se kjo do të shkelte të drejtat e të bashkakuzuarve të tij, sepse kryerja e dy gjykimeve paralelisht do të ngadalësonte procesin. Duke argumentuar se të dy çështjet gjyqësore përkojnë në njëfarë mase, ai parashtroi më tej se mund të lindë rreziku i vendimeve gjyqësore kontradiktore. Bashkim Smakaj, Isni Kilaj, Fadil Fazliu dhe Hajredin Kuçi e mbështetën plotësisht mocionin e z. Thaçi.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake vuri në dukje se, në rast se fazat e proceseve që kërkojnë më shumë kohë dhe burime do të përkojnë në kohë, mund të miratohen masa të duhura për të mundësuar procese paralele në një mënyrë që do të sigurojë pjesëmarrjen efektive të z. Thaçi në dy gjykimet. Ndër to mund të jenë: intervale të mjaftueshme mes seancave për të mundësuar përgatitjen e duhur, zgjatja e afateve kur të jetë e nevojshme, shtyrja e seancave me qëllim përgatitjen e mbrojtjes dhe bashkërendimi i afateve procedurale. Këto përshtatje mund të bëhen duke zvogëluar vonesat ose ndonjë dëm të mundshëm ndaj të akuzuarve të tjerë në këtë çështje dhe do të mbrojnë drejtësinë dhe efikasitetin e përgjithshëm të procesit.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake vuri në dukje gjithashtu se janë dy mbrojtës që e përfaqësojnë z. Thaçi në secilën çështje, të cilët mund ta organizojnë punën e tyre mbi këtë bazë. Ajo theksoi gjithashtu se është përgjegjësi e mbrojtësve që të vendosin nëse janë në gjendje t'i kryejnë detyrat dhe detyrimet e tyre. Sipas Gjykatësës së Procedurës Paraprake, argumentet për kufizimet financiare të z. Thaçi nuk mund të merren parasysh në dëm të bashkakuzuarve të tij në këtë çështje gjyqësore, dhe se ato duhet t'i paraqiten Administratores si autoriteti kompetent për trajtimin e kërkesave për ndihmë juridike.

Duke pasur parasysh se dy çështjet kanë të bëjnë me të akuzuar të ndryshëm, akuza të ndryshme dhe trupa gjykues të ndryshëm, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se argumentet e Mbrojtjes lidhur me rrezikun e vendimeve gjyqësore kontradiktore apo pasigurinë juridike janë të pathemelta.





Në lidhje me kërkesën e z. Thaçi për ta veçuar gjykimin e tij nga procesi kundër të bashkakuzuarve të tjerë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se të gjithë të akuzuarit në këtë çështje gjyqësore përballen me akuza të ngjashme, që e kanë bazën në të njëjtën praktikë të sjelljeve të pretenduara të z. Thaçi, i cili cilësohet si udhëheqësi i secilit grup dhe përfituesi kryesor i përpjekjeve për pengim. Rrjedhimisht, gjykimet më vete do të shkaktonin përsëritje të provave dhe të vendimeve procedurale, do të ishin të pavolitshme për dëshmitarët të cilët do të duhej të jepte dëshmi në dy gjykime të veçanta, dhe pashmangshmërisht do të merrnin më shumë kohë dhe burime gjyqësore.

Seanca e ardhshme në Dhomat e Specializuara do të jetë ajo për shqiptimin e Aktgjykimit të Apelit në çështjen gjyqësore të Pjetër Shalës, e caktuar për 14 korrik, në orën 11:30. Z. Shala ka apeluar vendimin e fajësisë si dhe urdhrin për zhdëmtim. Personat që dëshirojnë ta ndjekin seancën e shqiptimit të Aktgjykimit të Apelit nga galeria për publikun në Dhomat Specializuara në Hagë janë të lutur të regjistrohen në adresën [PUBLIC@scp-ks.org](mailto:PUBLIC@scp-ks.org). Seanca mund të ndiqet edhe nëpërmjet transmetimit të drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara.

